



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 684/1 prot.

Shkodër, më/3.10.2022

Nr. 5406/1 Prot
Dt. 13.10.22

Lënda: Mbi vendimin nr. 63, datë 10.10.2022 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës


KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 23, pika 12, neni 28, neni 40, pika 4, neni 55, pika 3, neni 64, shkronja "c", të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 28, 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën me Shqipërisë" i ndryshuar, neni 44, paragrafi i dytë, të Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit", pikat 100, të Udhëzimit Plotësues të MFE nr. 1, datë 10.01.2022 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022", kapitulli II, të VKB Vau Dejës nr. 72, datë 23.12.2021 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2022 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 të Bashkisë Vau Dejës", i ndryshuar, shqyrtoi **VKB Vau Dejës nr. 63, datë 10.10.2022 sipas dokumentacionit bashkëlidhur nr.5405 prot datë 11.10.22**, "Për shtesë dhe rishpërndarje të buxhetit të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2022 ndërmjet programeve me vlerë 3.696.678 lekë si dhe shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022 për rritjen e pagave për funksionin e arsimit parashkollor me burim buxhetin e shtetit në vlerën prej 907.404 lekë (me anë të shkresës së MFE nr.16040 prot datë 29.08.22 "Dërgohet fondi i rritjes së pagave¹ për arsimin parashkollor). Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon të procedoni konform procedurave të mëtejshme. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI

¹ Si pasojë e ndryshimit të nivelit të pagave me VKM nr.465, datë 6.7.2022 për disa ndryshime në VKM nr.175 datë 8.03.2017 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parashkollor".





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK



VENDIM

Nr. 63, datë 10.10.2022

**“PËR MIRATIMIN E RISHPËRNDARJES TË BUXHETIT TË BASHKISË
VAU DEJËS PËR VITIN 2022”**

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës 10.10.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 9 pika 1.3 shkronja “c”, nenet 18, 54 shkronja “dh”, neni 55 pika 3, neni 64 shkronja “c”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar ; neni 45 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar;

Ligji 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022", Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” neni 100 rishpërndarja e fondeve buxhetore të njësisë së vetëqeverisjes vendore: a) ndërmjet programeve miratohen nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Vendim i Këshillit Bashkiak nr 72 prot me datë 23.12.2021 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2022-2024, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës, të miratuar me shprehje ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 12/1 prot dhe datë 14.01.2022. Udhëzim plotësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr 1 datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit 2022”. Sipas relacionit financiar të përgatitur nga Administrata e Bashkisë Vau Dejës, në mbledhjen e datës 10.10.2022 me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I:

1. Miratimin e rishpërndarjes së buxhetit të vitit 2022, të Bashkisë Vau Dejës, si më poshtë:
 - a) Formatit nr 1 Plani i të ardhurave të veta
 - b) Formatit nr 2 Fondi për rritjen e pagave për funksionin e arsimit parashkollor
2. Këto projekte do të jone pjesë e buxhetit të vitit 2022.

3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”).

KRYETAR

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Ardian Celepija

Mark Bisha



Miratuar me 17 vota

Vota Pro 16

Vota Kundër —

Vota Abstenim 1 (një)

Zbardhur me datë 11.10.2022